



Prishtinë, 27.02.2026  
Kodi i ZRRE-së: V\_3145\_2026

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës me shenjë K.DH.SH.II.nr. 1424/25;
- Rekomandimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK\_R\_2899\_02\_26, i dt. 04.02.2026.

në seancën e mbajtur më datë 27.02.2026 nxori këtë:

### V E N D I M

- I. REFUZOHET** ankesa e subjektit juridik **L. I., SHPK.**, përfaqësuar sipas Autorizimit nga B. H., lidhur me kundërshtimin e liberalizimit të tregut të energjisë, si e pa bazuar.
- II.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- III.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

### A r s y e t i m

Subjekti L. I., SHPK., me datë 09.08.2025, ka parashtruar ankesë në Zyrën e Rregullatorit për Energji, përmes së cilës e kundërshton procesin e liberalizimit të tregut, me arsyetimin se e plotëson vetëm njërin kriter ligjor për të kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së e ka analizuar me kujdes rastin e konsumatorit dhe ndërlidhur me çështjen kryesore kontestuese, që subjekti L. I., SHPK me NUI , nuk i plotëson kriteret për të kaluar në tregun e hapur të energjisë elektrike, pasi që nuk i ka mbi 50 të punësuar dhe nuk i ka qarkullim vjetor mbi 10 mil/EUR për vitin 2024, ZRrE thekson se, duke iu referuar Procesverbalit të Inspektimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes KEDS me nr. 2214246, për konsumatorin L. I., SHPK, i hartuar me dt. 09.07.2025, ndër të tjera është evidentuar si në vijim: “Verifikohet njehsori dhe konstatojmë se, ky njehsor me nr. 39136920 e furnizon këtë objekt – lokal për shitjen e rrobave N. U., me NUI – I. SHPK – N. U., ky është qiramarrës”. Bashkëngjitur këtij njoftimi janë edhe fotografitë e objektit të paditësit, përmes të cilave vërtetohet një gjë e tillë. Subjekti juridik L. I., SHPK., e ka vetëm një pikë matëse/njehsor me shifër DPR – 90061376, ndërkaq, qiramarrësi që i plotëson kriteret për të kaluar në tregun e hapur dhe e shfrytëzon një pjesë të madhe të objektit të konsumatorit, nuk ka njehsor të veçantë, përmes të cilit do të faturoheshin vetëm shpenzimet e tij. Në këtë kuptim, ZRrE vlerëson se – paditësi, e shfrytëzon një hapësirë të caktuar të objektit, ndërkaq, një pjesë e tij është e lëshuar me qera. ZRrE ka qenë në dijeni që subjekti juridik/paditësi L. I., SHPK, nuk i plotëson kriteret sipas kërkesave ligjore të Ligjit për Energji Elektrike, por që, qiramarrësi i tij, N U. SHPK me NUI me 810110635, sipas Aktit Noterial me numër të referencës 1940/2024, i shfrytëzon 4200 m2, të objektit tregtar të paditësit L. I., dhe i



plotëson kriteret për të kaluar në tregun e hapur. Në bashkëndodhje të këtyre rrethanave, subjektet juridike, në cilësinë e shfrytëzuesve të këtyre hapësirave, nuk mund të amnistohen nga kalimi në tregun e hapur, kur i plotësojnë kriteret ligjore për të kaluar në treg, me arsyetimin se, subjekti juridik – qiradhënësi, si entitet i veçantë, dhe në emër të të cilit është shifra, nuk i plotëson kriteret për të kaluar në treg, dhe në anën tjetër, qiramarrësi e shfrytëzon pjesën më të madhe të hapësirës së këtij objekti. Thënë më ndryshe, një praktikë e tillë do të krijonte një precedent negativ, edhe për subjektet e tjera që potencialisht mund ta kundërshtojnë hapjen e tregut, përkundër plotësimit të kriterëve ligjore.

Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, është një detyrim ligjor, i përcaktuar me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2016. Në këtë kuptim, procesi i derregullimit dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, në ligjet e sektorit të energjisë, derivon nga obligimet kontraktuale që ka Republika e Kosovës, si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

ZRrE rithekson faktin se, procesi i liberalizimit, është i bazuar në dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085 dhe në vendimin përkatës të ZRrE-së, për daljen në tregun e hapur për ndërmarrjet ekonomike, të cilat e tejkalojnë njërin nga kriteret e përcaktuara – më shumë se 51 të punësuar ose qarkullim vjetor mbi 10 milionë EUR.

Po ashtu, edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, me shenjen P.A. nr. 18/2025, është vërtetuar se e drejta për furnizim me tarifa të rregulluara, u takon vetëm konsumatorëve të kualifikuar për Shërbim Universal, që është në përputhje të plotë me Vendimin e Bordit të ZRrE-së për tarifat me pakicë për vitin 2025 dhe Direktivën për Energji Elektrike të Bashkimit Evropian 2009/72/EC. ZRrE sipas dispozitave të Ligjit për Energjinë Elektrike, ka për obligim të përcaktojë tarifa të energjisë elektrike me pakicë, vetëm për konsumatorët e energjisë elektrike që e gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe jo për konsumatorët që nuk i plotësojnë kriteret e furnizimit me shërbim universal. Rrjedhimisht, Ligji për Energjinë Elektrike përcakton që, këta konsumatorë duhet të furnizohen në treg të hapur. Furnizimi me energji elektrike në tregun e hapur për këta konsumatorë, është detyrim ligjor dhe në këtë kuptim, i tejkalon kompetencat e ZRrE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundi.



**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Lutfije Dervishi, Anëtare

---

Gani Buçaj, Anëtar

---

Arta Isufi, Anëtare

---

Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- Arkivit të ZRrE-së
- Subjektit juridik L. I., SHPK., (B. H)